



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0161

PSH. nr. 0161/26

0163/26

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi Brajshori Kryetar, Batisha Ibrahim Anetar dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Dauti Komerc” SH.P.K. dhe ankesës së parashtruar nga Operatoret Ekonomik GOE “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K.lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 3 dhe Lot 5”, me numër të prokurimit: 201/26300-25-11214-1-1-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 08.04.2026, mori këtë:

Vendim

I. **Aprovohen**, si pjeserisht e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K.e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.03.2026 me numër protokolli 0163/26, si dhe ankesa e Operatorit Ekonomik “Dauti Komerc” SH.P.K. e parashtruar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me 16.03.2026 me numër protokolli 0161/26 për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 3 dhe Lot 5” me nr. të prokurimit 201/26300-25-11214-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues te pershkruar sipas pikes I. te ketij dispozitivi.

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K. dhe Operatorit Ekonomik “Dauti Komerc” SH.P.K.që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.12.2025, Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 3 dhe Lot 5” me numër të prokurimit: 201/26300-25-11214-1-1-1

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,010,000.00 €.

Me 04.03.2026, OE “Dauti Komerc” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 03.03.2026 po ashtu edhe OE “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 09.03.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 16/03/2026, OE “Dauti Komerc” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0161/26.

Ndërsa me datë 18/03/2026 OE “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0163/26.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0161/26 dhe ankesa nr. 0163/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dauti Komerc” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Ne pajtohemi me eliminimin e dy ofertuesve, pasi konsiderohet se kreditë e kushtëzuara nuk pranohen dhe, në çdo formë kushtëzimi, ato nuk i përmbushin kriteret e dosjes së tenderit.

Ndërsa për ofertuesin e rekomanduar për kontratë “Beni Dona”, kemi dyshime të bazuara se nuk e ka përmbushur gjithashtu kërkesën:

11.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, respektivisht Kërkesa 2:

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapacitet financiar për realizimin e kontratës, përmes mjeteve të gatshme në bankë ose mbështetjes bankare – qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës, ose bilanc pozitiv të “Paraja dhe ekuivalentët e parasë” në fund të vitit në Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025, në vlerë prej së paku:

- Lot 1 – 100,000.00 €;
- Lot 2 – 200,000.00 €.

Kjo për arsye se vetë fakti që dokumenti konsiderohet si sekret afarist ngre dyshime se kjo kërkesë nuk është përmbushur, duke u bazuar në dy pika:

1. Nëse operatori ekonomik ka mjete të gatshme në bankë, atëherë fakti që është rekomanduar për shpërbllim me kontratë për dy lote nënkupton se disponon mbi 300,000.00 € mjete të gatshme, çka nuk mund të konsiderohet sekret, pasi është një fakt lehtësisht i verifikueshëm.
2. Nëse bëhet fjalë për kredi, atëherë dokumenti nuk do të duhej të emërtohej “Dëshmi nga banka për mjete të gatshme”, siç është paraqitur. Ky dokument nuk na është ofruar as në versionin e pastruar pas kërkesës sonë për qasje në dokumente.

Andaj, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK) ka bërë shkelje të nenit 59 gjatë vlerësimit të ofertave, si dhe të nenit 11, duke mos ofruar qasje në këtë dokument, edhe pse i njëjti nuk ndikon në veprimtarinë afariste të asnjërës kompani.

Për këtë arsye, kërkojmë që, të paktën gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, të na bashkëngjiten pjesë të këtij dokumenti (ku vlerat apo të dhënat e ndjeshme mund të fshihen), në mënyrë që të verifikohet nëse bëhet fjalë për mjete të gatshme apo kredi, dhe nëse kjo kredi është e pakushtëzuar.

Bazuar në faktet e paraqitura, konsiderojmë se kemi të bëjmë me:

Shkelje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092:

Shkelja e Nenit 1 – Qëllimi Ligji për Prokurimin Publik ka për qëllim sigurimin e shfrytëzimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike. Autoriteti Kontraktues, duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara për mospërmbushje të kërkesave financiare, si dhe duke mos ofruar qasje në dokumentacion për shkak të “sekretit afarist”, ka vepruar në kundërshtim me këtë qëllim, duke cenuar transparencën dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.

Shkelja e Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

AK nuk ka siguruar përdorimin ekonomik dhe efikas të fondeve publike, pasi ka rekomanduar një operator ekonomik pa u verifikuar përmbushja reale e kapacitetit financiar, duke rrezikuar realizimin e kontratës.

Shkelja e Nenit 7 – Barazia në trajtim / Mosdiskriminimi AK nuk ka trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe transparente, pasi për operatorin e rekomanduar është pranuar dokumentacion i klasifikuar si sekret afarist dhe i paqasshëm për palët e tjera, ndërsa për ofertuesit e tjerë kriteret janë zbatuar në mënyrë rigoroze.

Shkelja e Nenit 52 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës Kriteret për kapacitet ekonomik dhe financiar nuk janë respektuar gjatë vlerësimit, pasi operatori i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të verifikueshme përmbushjen e tyre.

Shkelja e Nenit 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave AK ka konsideruar si të përgjegjshme një ofertë që nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht me kërkesën 11.2.3 për kapacitet ekonomik dhe financiar.

Shkelja e Nenit 60 – Kriteret e dhënies Kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” nuk është respektuar, pasi kontrata i është rekomanduar një operatori që nuk ka paraqitur ofertë të përgjegjshme.

Shkelja e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik – Neni 40 AK nuk ka kryer verifikim të plotë dhe të dokumentuar për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit, në kundërshtim me këtë dispozitë.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit AK ka aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi për operatorë të ndryshëm, duke qenë më rigoroz ndaj disa ofertuesve dhe më tolerant ndaj operatorit të rekomanduar.

Dyshim në ligjshmërinë e klasifikimit si “sekret afarist” Klasifikimi i dëshmisë për kapacitet financiar si sekret afarist është i pabazuar, pasi ky dokument nuk përmban informacione strategjike apo konkurruese, por vetëm dëshmon përmbushjen e një kriteri ligjor.

Demantim i pretendimit të AK-së për sekret afarist

1. Dokumenti nuk përbën sekret afarist në kuptimin material të ligjit.
2. Ai ka natyrë verifikuese dhe jo konkurruese.
3. Klasifikimi është bërë pa arsyetim konkret.
4. Neni 11 nuk lejon pengimin e verifikimit të ligjshmërisë së vendimit.
5. AK ka qenë e obliguar të ofrojë version të pastruar funksional që mundëson verifikim.
6. Versioni i ofruar nuk e përmbush këtë qëllim.

Përfundim -Bazuar në provat dhe faktet e paraqitura, kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë këtij procesi të sqarohen të gjitha pretendimet e ngritura.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Në cilësinë e Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE) për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me artikuj ushqimor” – Lot 5, paraqesim kërkesë për rishqyrtim të Njoftimit mbi Vendimin e

Autoritetit Kontraktues, të publikuar më 27.02.2026.

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit për eliminimin e ofertës sonë, bazuar në arsyetimin e dhënë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me Deklaratën për Themelimin e Grupit dhe dokumentin e përkrahjes bankare.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues Sipas Autoritetit Kontraktues, oferta jonë është eliminuar me arsyetimin se nuk është përmbushur kërkesa administrative lidhur me Deklaratën për Themelimin e Grupit, përkatësisht:

- Në pikën 5 të deklaratës janë paraqitur vetëm dy anëtarë të grupit me përqindje të pjesëmarrjes (75% dhe 25%);
- Një anëtar i grupit nuk figuron fare me përqindje të pjesëmarrjes në realizimin e kontratës, por vetëm me përgjegjësi për sigurimin e letrës së përkrahjes bankare;
- Letra e përkrahjes bankare nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, pasi konsiderohet si e kushtëzuar;
- Gjithashtu, është konstatuar se nuk është dëshmuar mjaftueshëm kapaciteti financiar sipas kërkesave.

Pretendimi 1 – Deklarata për Themelimin e Grupit -Eliminimi i ofertës sonë me arsyetimin se Deklarata për Themelimin e Grupit nuk është plotësuar si duhet është i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).

Ne kemi dorëzuar ofertë si Grup i Operatorëve Ekonomikë, ku: Dy anëtarë kanë pjesëmarrje operative në realizimin e kontratës (75% dhe 25%); Anëtar i tjetër, N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.), është angazhuar për mbështetje financiare përmes sigurimit të letrës së përkrahjes bankare.

Ky rol është plotësisht i ligjshëm dhe në përputhje me nenin 68.4 të LPP-së, i cili lejon që operatorët ekonomikë të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën juridike të lidhjes me to, me kusht që të dëshmohet disponueshmëria e burimeve.

Gjithashtu, sipas interpretimit zyrtar nr. 18 të datës 22.11.2022 nga KRPP:

“Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kërkesave financiare ose teknike dhe nuk mund të diskualifikohet për këtë arsye.”

Nga kjo rezulton se:

- Mbështetja në kapacitete të tjera është e lejuar;
- Nuk kërkohet që çdo anëtar i grupit të ketë pjesëmarrje operative në përqindje;
- Përgjegjës për realizimin e kontratës është grupi si tërësi.

Për më tepër, neni 71 i LPP-së nuk kërkon që çdo anëtar i grupit të ketë përqindje të realizimit të kontratës, por vetëm që kërkesat të përmbushen nga grupi në tërësi.

Prandaj, eliminimi i ofertës sonë për shkak të mungesës së përqindjes së një anëtarit është në kundërshtim me nenin 68.4 dhe nenin 71 të LPP-së, si dhe me interpretimin zyrtar të KRPP-së.

Pretendimi 2 – Dokumenti i përkrahjes bankare

Në dosjen e tenderit është kërkuar që kapaciteti financiar të dëshmohet përmes:

- mjeteve të gatshme në bankë, ose
- mbështetjes bankare / qasjes në kredi.

Ne kemi dorëzuar:

- letër përkrahjeje bankare nga institucion i licencuar;
- dëshmi për mjete të gatshme në bankë në vlerë prej 200,000 €.

Këto dokumente përmbushin plotësisht qëllimin e kriterit financiar.

Refuzimi i letrës bankare me arsyetimin se është “e kushtëzuar” është i padrejtë dhe joproporcional, pasi:

- forma e dokumentit është standarde dhe e përcaktuar nga banka;
- operatori ekonomik nuk mund të ndikojë në formatin e dokumentit;
- dokumenti dëshmon qartë disponueshmërinë e mbështetjes financiare.

Në rast paqartësie, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor, sipas nenit 72 të LPP-së, të kërkojë sqarime nga banka lëshuese.

Mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi dhe eliminimi i menjëhershëm i ofertës përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 72.

Gjithashtu, praktika e OSHP-së (rasti 2024/0352) konfirmon se Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë sqarime në raste të tilla.

Refuzimi i dokumenteve tona, pavarësisht se dëshmojnë kapacitet real financiar, përbën:

- shkelje të nenit 59 (parimi i proporcionalitetit);
- interpretim të gabuar të nenit 68 të LPP-së;
- cenim të konkurrencës së drejtë.

Pretendimi 3 – Shkelja e nenit 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik

Në përputhje me nenin 61.3 të Rregullores Nr. 002/2024, Autoriteti Kontraktues ka obligim të publikojë kërkesat për rishqyrtim në platformën elektronike të prokurimit.

Në rastin konkret, AQP nuk ka publikuar dy kërkesa për rishqyrtim, duke shkelur:

- parimin e transparencës;
- të drejtën e palëve për informim dhe mbikëqyrje të procesit.

Pretendimi 4 – Shkelja e parimeve themelore të LPP-së -Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer një operator ekonomik me çmim më të lartë, ndërkohë që oferta jonë ka qenë më e ulët për rreth 9,800 €.Ky veprim bie ndesh me:nenin 1 të LPP-së (efikasiteti dhe ekonomiciteti);

- nenin 7 (trajtim i barabartë dhe jo-diskriminim);
- nenin 59 (vlerësim objektiv i ofertave).

Për më tepër, ekzistojnë dyshime për trajtim jo të barabartë, pasi:

- oferta jonë është eliminuar për arsye formale;

- ndërsa oferta tjetër është shpallur fituese, pavarësisht çmimit më të lartë.

Kjo krijon perceptim të aplikimit selektiv të kritereve dhe cenon konkurrencën e ndershme.

Përfundim Bazuar në të gjitha sa më sipër, kërkojmë që:

- të anulohet vendimi për eliminimin e ofertës sonë;
- të rivlerësohet oferta jonë në përputhje me dispozitat ligjore;
- të sigurohet trajtim i barabartë dhe proces i drejtë i prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 19.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0161/2026 ndërsa me datën 23.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0163/2026, ndërsa me datë 02.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0161/26&0163/2026.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “Dauti Komerc” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0161 kanë vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin (B58) të AK – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e Nenit 59 të LPP-se, duke rekomanduar për kontrate OE të papergjegjshem.

Pretendimi nr. 1 OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 2 të kapacitetit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku AK ka kërkuar:

Kërkesa 2: Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës: mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës ose bilanc pozitive tek Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit në Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 - në vlerë prej së paku:

Lot 1 – 100,000.00€;

Lot 2 – 200,000.00€.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të shkresave të lëndës, konkretisht ofertën e OE të rekomanduar për kontrate lidhur me dëshmitë për kërkesën e cituar si më lartë, vlerëson se i rekomanduari për kontrate e ka plotësuar kërkesën nr. 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, konkretisht në dëshminë e dorëzuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontrate shihet se ka mjete mbi 300,000.00€ dhe për shkak se i njëjti ka dorëzuar në ofertën e tij kërkesën për sekret afarist, eksperti shqyrtues nuk mund të japë me shumë informacione, mirëpo dëshmia për panelin shqyrtues gjenden në platformën e E-Prokurimit. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 2 OE ankues pretendon se AK nuk i ka ofruar qasje të plote, për shkak të kërkesës për sekret afarist të cilën OE te rekomanduar për kontrate e ka dorëzuar ne ofertën e tij.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontrate e ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist dhe njeherit sqaron se OE ankues nuk ka pretendim tjetër lidhur ofertën e të rekomanduarit për kontrate.

Lidhur me pretendimet e OE “Hc Store” – “Meka” – “Fehmi Cakiqi” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0163 kanë vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1 Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 163/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për mjete të gatshme në bankë ose qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 200,000€.

Ak pretendon se: “Ju jeni eliminuar për arsye : është vlerësuar që nuk ka plotësuar kërkesën administrative lidhur me DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT ku tek pika 5 e kësaj deklarate paraqiten vetëm dy anëtarë të grupit që kanë % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës në raportet 75% me 25%, ndërsa një anëtarë i grupit nuk figuron fare tek përqindja e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës, pra një anëtarë i grupit figuron që nuk ka fare pjesëmarrje në realizimin e kontratës por ka vetëm përgjegjësin siç është cekur në këtë deklaratë citojmë: "Po ashtu N.P.T. AL - VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) merre përsipër si anëtar i grupit të nxjerrë letër përkrahëse kredie nga ndonjë bank e licensuar në emër të tenderit të publikuar nga AQP-ja.", me këtë rast në fakt kredia për këtë OE nuk plotëson kushtin për të cilin është kjo kërkesë që është me qellim që kontraktuesi të ketë likuiditet/mjete financiare për fillimin dhe realizimin e kontratës pa probleme. Gjithashtu edhe tek ky OE është vlerësuar që Letra e Referencës nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit pasi që në të ceket citojmë: "(emri i bankës) do të konsiderojë mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiare pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive për shumën e kërkuar...", pra përveç që ky dokument është i lëshuar për anëtarin e grupit që nuk pjesëmarrje në realizim të kontratës gjithashtu nuk është e lëshuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit ku kërkohet që të jetë qasje e pakushtëzuar. Ndërsa në një dokument tjetër për liderin e grupit është dëshmuar që me datën 29.12.2025 që ka pasur mjete financiare në një vlerë që nuk plotëson kushtin prej minimum 200,000€ siç është kërkuar...".

Ndërsa OE ankues përmes ankesës në OSHP ndër të tjera pretendon se:

“Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me nenin 68.4 dhe interpretimin zyrtar të KRPP, pasi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është grupi, dhe jo subjekti pa pjesëmarrje operative. Në rastin konkret në përmes letres bankare të OE N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) kemi dëshmuar për autoritetin kontraktues se do të kemi në dispozicion burimet e nevojshme. Interpretimi zyrtar i KRPP-se nr. 18 të datës 22.11.2022: "Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kërkesave financiare ose teknike dhe nuk mund të diskualifikohet pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik." Gjithashtu është theksuar se: "Është e drejtë e çdo operatori ekonomik të mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër; dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia për ekzekutimin e kontratës." Prandaj, eliminimi për shkak të mungesës së përqindjes operative bie ndesh me interpretimin zyrtar të autoritetit rregullator, respektivisht KRPP pasi që edhe sipas interpretimit të KRPP përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera dhe si rrjedhojë në këto rast Grup i Operatorëve

Ekonomik HC STORE SH.P.K.; MEKA SH.P.K.; është përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

Eksperti shqyrtues jep mendim se në pajtim me nenin 68 të LPP-së paragrafi 4, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera.

Në rastin konkret OE Femi Cakiqi është anëtar i grupit të OE ankues (i cili ka ofruar konfirmim nga banka se me 10.02.2026 ka pasur bilancin në dispozicion prej 236,037.62 EUR) dhe grupi mund të mbështet në kapacitet ekonomike të tij.

Në rastin konkret në dosje të tenderit nuk ka qenë e përcaktuar apo e kufizuar përqindja e obligative e pjesëmarrjes për liderin apo anëtarët, dhe pavarësisht se se anëtarit të tretë të OE nuk i është përcaktuar “përqindja e pjesëmarrjes” (fjali kjo që në vet vete paraqet sfidë pasi nuk ka formulë apo njësi që e përcakton “përqindjen e pjesëmarrjes”), eksperti shqyrtues jep mendim se grupi si tërësi mund të mbështet në kapacitet e anëtarit të grupit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar dhe se grupi i OE-ve mund të mbështet në kapacitet ekonomike të anëtarit të grupit.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të mbahet seanca dëgjimore me palë, përderisa lidhur me keto ankesa janë caktuar dy ekspert si dhe parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, nuk përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtresit e ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorëve ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik të rekomanduar, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, deklarimeve të palëve në procedure gjatë

seances dëgjimore, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues “Dauti Komerc SH.P.K.”- Prishtinë me nr: 2026/0161, bazuar ne faktet dhe argumentet e permendura si me lartë , PSH ia fal besimin raportit të ekspertit shqyrtës, pa nevoj që të njejtat të përseriten serish, rrjedhimisht PSH e lë ne fuqi vendimin e autoritetit kontraktues, keshtu duke vleresuar se OE i rekomanduar ploteson kriteret e parashtrurara ne DT.

Sa i përketë ankesës së dorëzuar nga GOE ankues “Hc Store; Meka;Fehmi Cakiqi SH.P.K.me nr: 2026/0163, bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura, eksperti me raportin e tij nuk ka arritur ta vërteton se OE ankues ka plotësuar kërkesat e parashtruara ne DT , keshtu PSH nuk e mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues sa i përketë eliminimit te GOE ankues lidhur me Deklaraten per Themelimin e Grupit te këtij GOE. Në rastin konkret ky grup operatoreve ekonomik kanë lidhur konzorcium me tre Operator Ekonomik , ku sipas këtij konzorciumi është caktuar Lider Operatori Ekonomik HC STORE SH.P.K, anetare tjerë pjesëmarrës janë OE MEKA SH.P.K dhe OE N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.). Sipas Deklarates per themelimin e grupit për anetarin N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) kontributi i këtij OE nuk eshte parashikuar fare, ngase përgjegjësia eshte ndare vetëm ne mes te Liderit te Grupit dhe njërit anëtar OE MEKA SH.P.K ndërsa anëtarit te tretë te këtij gupi N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) nuk i eshte ndare fare përgjegjësi.Deklaratën e dorëzuar nga GOE ankues dhe të formuar me këto ndarje te përgjegjësie:

a) [75 %) e pjesëmarrjes në realizimin e secilit Lot të kontratës për Lot, 3 & 5: Lideri: HC STORE” SHPK

b) [25%) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës Lot, 3 & 5, anëtari: MEKA SHPK

PSH vlereson se formulim i tille nuk ka plotesuar kriteret e parashtruara ne DT dhe po ashtu konstaton se anetari i grupit N.P.T. AL-VIS (Fehmi Cakiqi B.I.) perveq qe ka ofruar nje deklarate nga Banka i njejtë nuk ka ndonje kontribut tjetër ne implementimin e kontrates lidhur me kete aktivitet te prokurimit kur dihet se formimi i grupit behet pikrisht per mbeshtetje te kapaciteteve siç parashihet me dispozitat ligjore te nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe si i tille nuk ploteson kriteret e parapara ne DT.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatoreve Ekonomik duhet të aprovohen si pjeserisht te bazuara ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit –lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 3 dhe Lot 5” me numër të prokurimit: 201/26300-25-11214-1-1-1duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
ë këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Agjencia Qendrore e Prokruimit , Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- **OE - Dauti Komerc SH.P.K., HC STORE SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**